

Sokol Zeneli
Nëntor 2025

Dezinformimi dhe kërcënimet hibride

*Vlerësimi i kornizës rregullatore
të Kosovës kundër dezinformimit
dhe kërcënimeve hibride*

Imprint

Botuesi

Friedrich-Ebert-Stiftung, Zyra në Prishtinë
Rr. Pashko Vasa Nr. 23
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Përgjegjësia për përmbajtjen dhe redaktimin

Katharina Hofmann

Kontakti

Rudina Nallbani
rudina.nallbani@fes.de

Dizajni/Faqosja

Trembelat

Shtypja dhe prodhimi

Studio Forma

Ky dokument është shkruar fillimisht në anglisht. Në rast të ndonjë paqartësie ose mospërputhjeje, ju lutemi referojuni versionit në anglisht të dokumentit. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk janë domosdoshmërisht ato të Friedrich-Ebert-Stiftung e.V. (FES). Përdorimi komercial i mediave të publikuara nga FES nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim të FES. Publikimet e FES nuk mund të përdoren për qëllime fushate zgjedhore.

Nëntor 2025

© Friedrich-Ebert-Stiftung e.V.

Publikime të mëtejshme të Friedrich-Ebert-Stiftung mund të gjenden:

➤ www.fes.de/publikationen



Dezinformimi dhe kërcënimet hibride

Vlerësimi i kornizës rregullatore të Kosovës kundër
dezinformimit dhe kërcënimeve hibride

Përmbajtja

Përmbajtja	3
Shënim	3
Rekomandimet kryesore	4
Metodologjia	5
Informata të përgjithshme dhe konteksti	8
Kuadri rregullativ	12
Zbatimi i kornizës analitike të politikave	15
Ligji civil nr. 02/L-65 kundër shpifjes dhe fyerjes	15
Ligji nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale	16
Ligji nr. 08/L-173 për sigurinë kibernetike	17
Udhëzimi Administrativ nr. 04/2024 për Regjistrin e incidenteve kibernetike	19
Udhëzimi Administrativ nr. 04/2024 për Regjistrin e rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë kibernetike	20
Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2023–2027	21
Strategjia Kombëtare e Sigurisë 2022–2027	22
Ligji nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM)	23
Kodi i Mediave të Shkruara (KPM-2016/03)	24
Kodi i Mediave të Shkruara i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ..	25
Agjenda Digjitale për Kosovën 2030	26
Diskutim i gjetjeve	27
Konkluzione dhe rekomandimet	29

Rekomandimet kryesore

Në vijim janë paraqitur rekomandimet kryesore për hartimin e një kornize më reziliente rregullative dhe shoqërore:

Modernizimi i kornizës rregullative të mediave për të përfshirë edhe sferën e mediave dhe platformave online - Qeveria duhet të reformojë thellësisht Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), për t'i dhënë mandat të qartë dhe të zgjeruar mbi mbikëqyrjen e mediave online, përfshirë portalet informative dhe platformat digjitale, si dhe të sigurojë që Komision të posedojë burime dhe pavarësi të mjaftueshme për të realizuar mandatin e tij.

Rritja e transparencës dhe llogaridhënies për platformat online – Të miratohet ose ndryshohet e plotësohet legjislacioni në përputhje me Aktin e Shërbimeve Digjitale të BE-së (DSA), veçanërisht kriteret për transparencë mbi reklamimin online me baza politike, duke kërkuar etiketim të qartë të përmbajtjes së sponsorizuar nga shteti, si dhe të përmbajtjes së sponsorizuar ose të shtyrë politikisht.

Integrimi i masave kundër dezinformimit në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare – Të rishikohet Strategjia e Sigurisë së Kosovës për t'i përcaktuar qartë dhe integruar veprimet kundër dezinformimit dhe kërcënimeve hibride si prioritet kyq, duke përcaktuar kështu role të qarta për bashkëpunim ndërinstytucional dhe përafrim strategjik me Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike.

Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Edukimin Mediatik dhe Informativ – Të hartohet dhe zbatohet strategjia kombëtare gjithëpërfshirëse dhe afatgjate për ndërtimin e reziliencës shoqërore përmes integritit të edukimit mediatik dhe informativ në sistemin arsimor formal dhe përmes programeve të vazhdueshme të vetëdijesimit publik për të gjithë qytetarët.

Shënim

Ky dokument politikash u zhvillua si pjesë e projektit “Vlerësimi i Reziliencës së Shoqërisë Kosovare ndaj Goditjeve Ekologjike dhe Institucionale”. Një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse e vlerësimit, e cila mbështet analizën e paraqitur këtu, është në dispozicion me kërkesë. Ju lutemi t'i dërgoni kërkesat tuaja në info@re-actlab.org.

Hyrje

Në një epokë të karakterizuar me konkurrencë gjeopolitike komplekse, stabiliteti dhe zhvillimi demokratik i shteteve të vogla si Kosova përballen me sfida të paprecedentë. Institucionet e Kosovës operojnë në një peisazh të ndërlikuar gjeopolitik, të ndikuar ngashtetësia e kontestuar, tensionet etnike historike në rajon si dhe konkurrenca strategjike midis fuqive rajonale dhe globale si Rusia, Kina, Turqia, Shtetet e Gjirit Persik (Emiratet e Bashkuara Arabe, Arabia Saudite, Katari dhe Kuvajti), krahas Bashkimit Evropian (BE) dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA). Ky konteskt krijon terren të favorshëm për ndikime të jashtme dhe destabilitet, duke shtuar ndjeshmërinë e shoqërisë dhe institucioneve të Kosovës ndaj goditjeve destabilizuese, veçanërisht ndaj dezinformimit dhe kërcënimeve hibride. Këto goditje nuk janë rreziqe abstrakte por sfida të vazhdueshme dhe të prekshme që ndikojnë në sigurinë, kohezionin shoqëror dhe zhvillimin demokratik të Kosovës.

“Këto goditje nuk janë rreziqe abstrakte por sfida të vazhdueshme dhe të prekshme që ndikojnë në sigurinë, kohezionin shoqëror dhe zhvillimin demokratik të Kosovës.”

Çështja thelbësore që synojmë të trajtojmë është brishtësia akute e strukturave institucionale dhe shoqërore të Kosovës përballë dezinformimit dhe kërcënimeve hibride. Edhe pse gjithnjë e më shumë po rritet dokumentimi i burimeve dhe formave të fushatave të dezinformimit, që nga narrativat e sponsorizuara nga shtetet që synojnë të delegjitimojnë shtetësinë e Kosovës, e deri te dinamika e brendshme e një peizazhi mediatik të përballur me “clickbait” dhe informacione të pa verifikuara, ende ekziston një hendek kritik në vlerësimin sistematik të reziliencës së kuadrit ekzistues rregullativ për t’u përballur me këto goditje dhe për t’iu kundërpërgjigjur atyre. Trajtimi i kërcënimeve hibride - të përbëra nga kombinimi i qëllimshëm i masave të fshehta dhe të hapura, duke përfshirë operacionet kibernetike, shantazhet politike dhe manipulimin e narrativave kulturore e fetare - kërkon një mekanizëm reagimi holistik dhe adaptiv, të cilin kuadri rregullativ aktual në Kosovë nuk e ofron në masë të mjaftueshme. Vazhdimësia e ndarjeve etnike, si dhe dobësitë socio-ekonomike si dhe rastet e raportuara të ndikimeve të huaja që i shfrytëzojnë këto ndarje, theksojnë urgjencën e këtij vlerësimi.

Ky dokument politikash synon të vlerësojë në mënyrë kritike përgatitjen rregullative të Kosovës, në veçanti kapacitetin e saj për reziliencë ndaj sfidave të ndryshme, por njëherazi të ndërlidhura të dezinformimit dhe kërcënimeve hibride. Qëllimi kryesor është që përtej katalogimit të kërcënimeve, të analizohet kapaciteti ekzistues i kuadrit ligjor, politik dhe institucional për të parashikuar, përthithur, përshtatur dhe rimëkëmbur nga goditje të tilla. Seksioni vijues shpjegon metodologjinë e aplikuar për këtë analizë. Seksionet pasuese ofrojnë një pasqyrë të detajuar të kuadrit rregullativ të Kosovës në raport me këto goditje, pasuar me një aplikim të thelluar të kornizës së 4R-ve për politikën e përzgjedhura. Rezultatet e këtij vlerësimi do të shtjellohen tutje, duke nënvizuar dobësitë sistematike dhe fushat e shqetësimit. Dokumenti përfundon duke ofruar rekomandime specifike, të hartuara për të forcuar reziliencën institucionale dhe shoqërore të Kosovës, me synimin për të nxitur qasje më të fortë dhe më adaptive dhe që respekton të drejtat, në përputhje me praktikën më të mira evropiane, për trajtimin e dezinformimit dhe kërcënimeve hibride.

Metodologjia

Kjo përmbledhje politikash është pjesë e një hulumtimi më të gjerë mbi goditjet institucionale me të cilat përballet Kosova. Ky hulumtim aplikon një kornizë sistematike të analizimit të politikave, e projektuar për të vlerësuar reziliencën e kornizës ekzistues rregullatore të Kosovës (politika, ligje, akte nënligjore, strategji, dokumente qeveritare etj.) ndaj disa goditjeve. Procesi i hulumtimit ka ndjekur një rrjedhë të strukturuar të përbërë nga tri faza kryesore: (i) identifikimi i natyrës së goditjes, (ii) vlerësimi i reagimeve aktuale të politikave përmes një sistemi të vlerësimit, dhe (iii) hartimi i rekomandimeve të bazuara në gjetjet dhe praktikatat më të mira.

Klasifikimi i natyrës së goditjeve bazohet në kuadrin e zhvilluar nga OECD në vitin 2014, siç shpjegohet në tabelën më poshtë:

Tabela 1. Klasifikimi i goditjeve¹

Llojet e goditjeve	Karakteristikat	Shembuj
Goditja kovariante (Të përhapura, sistemike dhe jo të shpeshta)	Ngjarje në shkallë të gjerë që kanë ndikim në një pjesë të madhe të popullsisë përnjëherë. Nuk ndodhin shpesh, por ndikimi i tyre është i gjerë dhe sistematik.	Konfliktet të dhunshme dhe krizat politike, pandemitë dhe krizat shëndetësore, fatkeqësitë natyrore në nivel të gjerë, kërcënimet kibernetike dhe hibride.
Goditjet sezonale (Të përsëritura, të parashikueshme dhe të lokalizuara)	Goditje periodike që ndodhin në intervale të rregullta, shpeshherë të lidhura me ndryshimet sezonale ose trendet klimatike. Zakonisht të parashikueshme, por mungesa e përgatitjes adekuate mund ta përkeqësojë ndikimin e tyre.	Përmytjet dhe thatësitat vjetore, valët e nxehtësisë dhe të ftohtit, pasiguritë sezonale të ushqimit, rreziqet shëndetësore që përsëriten.
Stresorët afatgjatë (Erozion i ngadalshëm, kumulativ dhe sistematik i reziliencës)	Ndryshe nga goditjet, stresorët afatgjatë zhvillohen ngadalë, përgjatë kohës, dhe dobësojnë sistemet shoqërore. Ato janë shpeshherë goditje strukturore, mjedisore, ekonomike ose shoqërore që kërkojnë reagim politikash.	Degradimi mjedisor, ndryshimet demografike, stagnimi ekonomik dhe pabarazia, institucione dhe qeverisje të dobëta.

Për të vlerësuar efektivitetin e kuadrit rregullativ në përballimin e goditjeve të ndryshme, mbështetemi në kuadrin e 4R-ve të Reziliencës. Ky kuadër vlerëson politikatat kundrejt katër dimensioneve kryesore të reziliencës:

Tabela 2: 4R-të e Kornizës së Reziliencës

Korniza	Kategoria	Përkufizimi
4R-të e Reziliencës	Qëndrueshmëria (Robustness)	Fuqia apo aftësia e elementeve, sistemeve dhe njësive të tjera të analizës për t'i bërë ballë një niveli të caktuar stresi ose kërkese pa pësuar degradim apo humbje funksioni.
	Kapacitetet rezervë (Redundancy)	Disponueshmëria e burimeve alternative gjatë procesit të rimëkëmbjes së një sistemi.
	Resurset	Kapaciteti për t'i identifikuar problemet, përcaktuar prioritetet dhe mobilizuar resurset kur mbizotërojnë kushte që mund të rrezikojnë ndërprerjen e ndonjë elementi, sistemi ose njësie tjetër të analizës.
	Shpejtësia (Rapidity)	Kapaciteti për t'i përbushur prioritetet dhe arritur objektivat në kohë, në mënyrë që të kufizohen humbjet dhe të evitohen pengesat e ardhshme.

Çdo burim i identifikuar si pjesë e kuadrit rregullativ që adreson goditjet vlerësohet kundrejt kuadrit të 4R-ve duke përdorur një sistem të strukturuar vlerësimi, siç shpjegohet më poshtë:

Tabela 3. Sistemi i vlerësimit i bazuar në Kornizën e 4R-ve

Vlerësimi	
Qëndrueshmëria (Robustness)	0: Mungesë e qëndrueshmërisë - politika nuk adreson stabilitetin përballë goditjeve. 1: Masa të dobëta ose simbolike me pak zbatim. 2: Ka mekanizma të moderuar, por nuk zbatohen në mënyrë konsistente. 3: Mekanizma të fortë me zbatim të mirë që sigurojnë stabilitet.
Kapacitetet rezervë (Redundancy)	0: Nuk ka kapacitete rezervë - dështimi i sistemit kryesor çon në kolaps. 1: Alternativa minimale ose joformale që nuk janë të besueshme. 2: Ka pak kapacitete rezervë, por ekzistojnë zbrazëtira në mbulim ose efikasitet. 3: Kapacitete rezervë të mirë integruara që sigurojnë vazhdimësi nën stres/goditje.
Resurset	0: Nuk ka resurse—qasje reaktive në vend të asaj proaktive. 1: Përshtatshmëri e kufizuar - mekanizmat e reagimit janë të dobët ose ad hoc/momental. 2: Aftësi mesatare për t'i mobilizuar resurset, por ende ka boshllëqe. 3: Mekanizma reagimi shumë fleksibil dhe të koordinuar mirë.
Shpejtësia (Rapidity)	0: Nuk ka mekanizma të reagimit të shpejtë - reagime të vonuara ose mungojnë fare. 1: Reagim i ngadaltë dhe burokratik me joefikasitete të mëdha. 2: Shpejtësi mesatare, por me disa pengesa. 3: Reagim shumë efikas dhe i shpejtë që siguron veprim të shpejtë.

Nota totale e reziliencës së politikave (0-12) normalizohet më pas në përqindje, duke mundësuar vlerësim krahasues midis politikave dhe sektorëve të ndryshëm.

Tabela 4. Interpretimi i notimit

Interpretimi i vlerësimit		
0-25% (0-3 pikë)	Reziliencë shumë e ulët	Politika e lë shoqërinë në nivel tejet të ndjeshëm ndaj goditjeve, duke ofruar pak mbrojtje ose aftësi reagimi.
26-50% (4-6 pikë)	Reziliencë e ulët	Ekzistojnë disa masa të reziliencës, por ato janë të dobëta, jokonsistente ose të paplota.
51-75% (7-9 pikë)	Reziliencë mesatare	Politika siguron një nivel të arsyeshëm të përgatitjes dhe reagimit, por mbesin disa boshllëqe kritike.
76-100% (10-12 pikë)	Reziliencë e lartë	Politika është e hartuar mirë, me mekanizma të fortë që sigurojnë stabilitet, përshtatshmëri dhe reagim të shpejtë.

Për metodologji më të detajuar hulumtuese, ju lutemi referojuni Kornizës së Analizimit të Politikave të hartuar për këtë hulumtim. Mund ta gjeni në këtë [link](#).

Informata të përgjithshme dhe konteksti

Dezinformimi dhe kërcënimet hibride janë goditje kovariante, të cilat ndryshojnë varësisht nga shpeshësia dhe kanë ndikim sistemik negativ në shoqëri dhe në zhvillimet politike përreth. Dezinformimi i referohet krijimit dhe përhapjes së qëllimshme dhe sistematike të informacionit të rremë, të njëanshëm ose manipulues, me qëllim që të mashtrohen audienat e targetuara dhe të arrihen objektivat e caktuara.² Ky dezinformim shpërndahet përmes portaleve në internet, mediave sociale dhe fushatave të koordinuara që synojnë t'i shfrytëzojnë ndasitë ekzistuese shoqërore.³ Kërcënimet hibride, nga ana tjetër, i referohen përdorimit më të gjerë të dezinformimit si mjet, për të përfshirë edhe veprime të tjera armiqësore, si presioni politik, shtrengimi ekonomik, operacionet kibernetike, manipulimet kulturore dhe fetare, të realizuara nga aktorë shtetërorë ose joshtetërorë për ta destabilizuar Kosovën, për t'i shfrytëzuar dobësitë e saj dhe për t'i përmbushur qëllimet strategjike pa përdorur konflikt të drejtpërdrejtë.⁴ Të dy fenomenet janë thellësisht të ndërlidhura; dezinformimi shpesh përgatit terrenin për taktika të tjera hibride ose i amplifikon efektet e tyre, duke çuar në konfuzion, mosbesim dhe polarizim të përgjithshëm, e duke i bërë kështu institucionet dhe shoqërinë më të ndjeshme ndaj manipulimit dhe presionit.

“Ndjeshmëria e Kosovës ndaj këtyre goditjeve nuk është zhvillim i ri, por pasojë e realiteteve pas-konfliktuale dhe e pozitës së vendit si pikë presioni gjeopolitik.”

Ndjeshmëria e Kosovës ndaj këtyre goditjeve nuk është zhvillim i ri, por pasojë e realiteteve pas-konfliktuale dhe e pozitës së vendit si pikë presioni gjeopolitik. Trashëgimia e konflikteve, shtetësia e kontestuar dhe ndarjet etnike krijojnë dobësi që aktorë të brendshëm dhe të jashtëm vazhdojnë t'i shfrytëzojnë. Për shembull, konflikti me Serbinë historikisht ka lejuar që nacionalizmi etnik të lulëzojë në të dyja anët, shpeshherë duke dominuar diskursin publik dhe agjendat politike.

Po ashtu, ndikimet e huaja kanë qenë gjithmonë të pranishme, me aktorë të ndryshëm që ndjekin agjenda të ndryshme, ndonëse shpeshherë të mbivendosura, të cilat ndikojnë në stabilitetin dhe konsolidimin demokratik të vendit.⁵ Serbia, shpesh me mbështetjen e Rusisë, është angazhuar në fushata të gjata dezinformimi që synojnë të delegjitimojnë pavarësinë e Kosovës, ta paraqesin si të jostabile apo të rrezikshme (veçanërisht për

serbët), dhe ta sabotojë integrimin e saj në strukturat ndërkombëtare.⁶ Shumica e këtij dezinformimi hyn në Kosovë përmes mediave në gjuhën serbe, disa prej të cilave financohen drejtpërdrejt nga Beogradi ose janë të lidhura me mediat shtetërore ruse si dega e Sputnik në Serbi.⁷ Këto narrativa më pas përhapen brenda Kosovës, kryesisht në zonat me shumicë serbe, por shpesh merren edhe nga mediat online në gjuhën shqipe që ndjekin klikime.⁸ Për shembull, vetëm në vitin 2018, janë publikuar jo më pak se 700 lajme të rreme nga media serbe që raportonin për një “luftë të pashmangshme” midis Kosovës dhe Serbisë.⁹ Një dinamikë e ngjashme ishte e pranishme edhe gjatë zgjedhjeve serbe të vitit 2022.¹⁰

Edhe aktorë të tjerë ndikojnë në zhvillimet në Kosovë. Turqia, për shembull, ka krijuar lidhje me Kosovën përmes investimeve të rëndësishme ekonomike, diplomacisë kulturore dhe fetare përmes Agjencisë për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) – duke përfshirë financimin e xhamive, platformave mediatike si TRT Balkan¹¹, ofrimin e mundësive arsimore, dhe bashkëpunimit në mbrojtje.¹² Megjithatë, ndikimi i Turqisë është shfaqur në mënyra shqetësuese, si në vitin 2018 me rrëmbimin e fshehtë të gjashtë shtetasve turq të dyshuar si përkrahës të Gylenit, që ekspozoi dobësinë dhe ndjeshmërinë e strukturave paralele brenda aparatit të sigurisë së Kosovës ndaj presioneve të huaja.¹³ Ndikimi i Turqisë mbetet i fortë edhe sot, siç u paraqit në dy anulimet e njëpasnjëshme të shfaqjes “Gjashtëshja Kundër Turqisë” në Kosovë. Shfaqja trajton ngjarjet që çuan në deportimin e gjashtë mësuesve turq në vitin 2018. Autorët e saj argumentuan se anulimi ndodhi për shkak të ndikimit të Ambasadës së Turqisë në Kosovë.¹⁴ Fillimisht anulimi u arsyetua me “çështje teknike”, ndërsa më vonë u njoftua se shfaqja u anulua pasi “është kundër vlerave të komunitetit turk” dhe “kundër Turqisë dhe Presidentit të saj”.¹⁵

Edhe Shtetet e Gjirit Persik (veçanërisht Arabia Saudite) kanë ndikim të konsiderueshëm në Kosovë. Ky ndikim zakonisht lidhet me përhapjen e interpretimit konservator vahabist të Islamit dhe, në disa raste, ka ofruar kanale për radikalizim dhe rekrutim nga grupe ekstremiste që shfrytëzojnë marginalizimin socio-ekonomik në zonat e neglizhuara nga shteti.¹⁶

Kina, nga ana tjetër, megjithëse ka prani më të kufizuar në Kosovë, vazhdon të ndikojë në rajon përmes investimeve infrastrukturore në kuadër të iniciativës Belt and Road¹⁷, si dhe përmes furnizimit me teknologji, si sistemet e vëzhgimit që përdor Kosova, duke ngritur shqetësime për varësi të mundshme dhe promovimin e modeleve alternative të qeverisjes.¹⁸ Për shembull, Kosova ka instaluar rreth 3,500 kamera mbikëqyrjeje me kapacitete të identifikimit të fytyrës, të prodhuara nga kompanitë kineze Dahua dhe Hikvision.¹⁹ Kjo e fundit është futur në listën e zezë të SHBA-së.

Këto presione dhe ndikime përkeqësohen më tej nga faktorët e brendshëm në vend. Peisazhi mediatik i Kosovës, veçanërisht sektori online, përballet me dobësi sistemike. Mungesa e rregullimit efektiv, strukturat

jotransparente të pronësisë që shpeshherë lidhen me interesa politike ose biznesore, si dhe konkurrenca e fortë, kontribuojnë në përhapjen e dezinformimit.²⁰ Përpjekjet për të miratuar një rregullore për mediat online historikisht kanë hasur në rezistencë ose kanë dështuar të materializohen²¹, ndërsa kapaciteti institucional për t'u përballur me fushatat e dezinformimit dhe kërcënimet hibride mbetet i dobët, me mungesë të ndërgjegjësimit, burime të pamjaftueshme dhe strategji të pakoordinuara.

Pasojat e këtyre goditjeve janë të thella, duke ndikuar jo vetëm në stabilitetin institucional, por edhe duke shkaktuar dëme të drejtpërdrejta për qytetarët dhe shoqërinë. Një nga ndikimet më të dëmshme mbetet zbehja e besimit – qoftë ndërmjet qytetarëve dhe shtetit, ndërmjet komuniteteve etnike, apo besimit në media – e nxitur nga narrativat e korrupsionit, njëanshmërisë dhe amplifikimi i vazhdueshëm i pakënaqësi-ve etnike. Për më tepër, duke shfrytëzuar dobësitë socio-ekonomike të shoqërisë kosovare, dezinformimi dhe kërcënimet hibride përdoren për të krijuar rrugë që çojnë drejt radikalizimit. Siç është dëshmuar, neglizhenca, varfëria, papunësia dhe qasja e kufizuar në arsim në komunitetet e marginalizuara krijuan hapësirë që grupet fetare ekstremiste, të financuara nga aktorë të huaj, të përhapin ideologji radikale, duke çuar kështu në pasoja tragjike si bashkimi i qytetarëve në luftëra të huaja.

Përhapja e vazhdueshme e narrativave për një konflikt të mundshëm, kërcënime etnike, dështimi shtetëror apo agresion të jashtëm rrit ndjenjën e ankthit dhe pasigurisë tek qytetarët dhe mund të kontribuojë në ikje të trurit. Fushatat e dezinformimit në Kosovë pothuajse ekskluzivisht krijojnë panik ose alarmim, duke synuar në veçanti komunitetet pakicë, për t'i arritur qëllimet politike ose për të minuar besimin në të ardhmen e Kosovës.²² Po ashtu, këto goditje ndikojnë drejtpërdrejt në integritetin dhe funksionalitetin institucional. Fushatat keqdashëse minojnë efektivitetin e qeverisjes dhe sundimin e ligjit, shpeshherë duke shfrytëzuar ose thelluar dobësitë ekzistuese, si perceptimi i korrupsionit, favorizimi politik ose joefikasiteti. Kjo çon në erozion të legjitimitetit institucional, si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Reziqet që paraqesin dezinformimi dhe kërcënimet hibride për institucionet dhe shoqërinë e Kosovës nuk pritët të zvogëlohen, madje edhe mund të forcohen në mungesë të përpjekjeve të duhura për t'i adresuar ato. Tensionet e vazhdueshme gjeopolitike lidhur me statusin e Kosovës dhe dinamikat e fuqive rajonale garantojnë se do të mbetet shënjestër për aktorët e jashtëm që kërkojnë të ushtrojnë ndikim, të ruajnë mungesën e stabilitetit ose ta pengojnë rrugën euroatlantike të Kosovës. Për më tepër, metodat e përdorura në kërcënimet hibride ndryshojnë vazhdimisht, duke i shfrytëzuar avancimet teknologjike për ta rritur shpejtësinë, shkallën dhe sofistikimin e fushatave të dezinformimit dhe operacioneve kibernetike. Mbetet shqetësues kapaciteti institucional i Kosovës për t'u përballur me këto kërcënime që janë gjithnjë në ndryshim, duke parë që ende ka mangësi në kuadrin ligjor, shkathhtësitë teknike, burimet njerëzore, si dhe mungesë koordinimi strategjik.

Kuadri rregullativ

Kuadri rregullativ – që përfshin ligjet, rregulloret, strategjitë dhe politikat e tjera – është thelbësor për Kosovën në adresimin dhe zgjidhjen e këtyre goditjeve. Përveç kësaj, ky kuadër duhet të jetë rezilient ashtu që t'i ndihmojë institucionet dhe shoqërinë që t'i përballojnë këto goditje. Aktualisht, megjithëse ekziston një kuadër rregullativ përkatës, ai karakterizohet me dobësi të konsiderueshme, legjislacion të vjetruar dhe përgjegjësi të fragmentuara.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës është themeli i këtij kuadri rregullativ. Ajo garanton të drejtat themelore që kanë të bëjnë me hapësirën e informacionit. Më saktësisht, nenet 40 dhe 42 mbrojnë shprehimisht lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave dhe pluralizmin, duke garantuar të drejtën për të shpërndarë dhe marrë informacion, ndërsa ndalon censurën.²³ Nëpërmjet kësaj, Kushtetuta krijon bazën për një mjedis të hapur informimi, i cili megjithatë kërkon legjislacion dhe rregullore mbështetëse për funksionim adekuat përballë goditjeve të ndryshme, përfshirë dezinformimin dhe kërcënimet hibride.

Në këtë drejtim, disa ligje trajtojnë aspekte të integritetit dhe llogaridhënies së informacionit. Në veçanti, **Ligji kundër shpifjes dhe fyerjes** përcakton standardet për kompensimin e individëve reputacioni i të cilëve dëmtohet, duke synuar balancimin e mbrojtjes së reputacionit me lirinë e shprehjes.²⁴ Ligjet e tjera janë ai **mbrojtjen e burimeve gazetareske**²⁵, ligji për **sinjalizuesit**²⁶, ligji për **qasjen në dokumentet publike**²⁷, si dhe ligji për **mbrojtjen e të dhënave personale**²⁸. Edhe pse këto janë ligje të rëndësishme, ato kryesisht adresojnë dëmet individuale ose të drejtat procedurale, dhe jo sfidën sistematike të fushatave të koordinuara të dezinformimit apo të kërcënimeve hibride. Në përgjithësi, Kosovës i mungojnë ligje specifike që rregullojnë aspekte thelbësore të mjedisit modern mediatik, si financimi dhe pronësia e mediave, veçanërisht për subjektet online²⁹, duke lënë kështu hapësirë të konsiderueshme të paeksploruar dhe të parregulluar për ndikimet e fshehta.

Organi kryesor rregullativ për mediat është **Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)**, i themeluar në bazë të nenit 141 të Kushtetutës. Mandati i tij përfshin rregullimin e frekuencave të transmetimit, licencimin e transmetuesve publikë dhe privatë audio e audiovizuel, si dhe zbatimin e politikave të transmetimit.³⁰ Megjithatë, ky ligj konsiderohet përgjithësisht si i vjetruar dhe i papërshtatshëm për epokën digjitale.³¹ Ajo që është më shqetësuese në këtë drejtim është fakti se autoriteti i KPM-së nuk shtrihet mbi mediat online (portalet e lajmeve, platformat e mediave sociale etj.), të cilat luajnë rol kyç në përhapjen e dezinformimit. Ky kuadër rregullativ është megjithatë i rëndësishëm. Për shembull, KPM-ja ka autoritet që të kërkojë heqjen e kanaleve nga operatorët transmetues, siç ndodhi pas pushtimit rus të Ukrainës, kur urdhëroi heqjen e Russia Today, Russia 24 dhe Planeta RTR për të parandaluar propagandën.³² Megjithatë, pasi ky autoritet nuk shtrihet mbi mediat online, ato mbeten me rrezikun e amplifikimit të dezinformimit dhe propagandës pa asnjë kufizim. Për më tepër, duke marrë parasysh se anëtarët e bordit të KPM-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës³³, ka shqetësime të shprehura lidhur me pavarësinë e saj.

“KPM-ja ka autoritet që të kërkojë heqjen e kanaleve nga operatorët transmetues. Megjithatë, ky autoritet nuk shtrihet mbi mediat online”

Puna e mediave online bie nën juridiksionin e **Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK)**, i cili është organ vetërregullues i themeluar nga sektori i mediave. Puna e KMSHK-së udhëhiqet nga **Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës** dhe trajton ankesat e ndryshme për shkelje etike nga mediat e shkruara dhe ato online.³⁴ Dobësia më e madhe e KMSHK-së mbetet pamundësia për t'i zbatuar vendimet e saj; institucioni nuk mund të shqiptojë gjopa ose të revokojë licenca, gjë që kufizon efektivitetin e saj në përpjekjet për ta luftuar dezinformimin dhe kërcënimet hibride të përhapura nga mediat online.

Përpjekjet e qeverisë dhe të institucioneve publike për ta forcuar kuadrin rregullativ për luftimin e dezinformimit janë kundërshtuar gjerësisht nga trupat mediatike si **KMSHK** dhe **Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK)**, për shkak të frikës nga cenimi i lirisë së shprehjes.³⁵ Përpjekjet e mëparshme të qeverisë në këtë drejtim përfshijnë Projektligjin për Mediat (2018) dhe propozimin për ta trajtuar “lajmin e rremë” si gjuhë urrejtjeje në kuadër të Kodit Penal të Kosovës.³⁶

Për i përket sigurisë kibernetike, si komponent kritik i përballjes me kërcënimet hibride, Kosova miratoi **Ligjin për sigurinë kibernetike** më 2023.³⁷ Ky legjislacion çoi në krijimin e **Agjencisë së Sigurisë Kibernetike (ASK)**, e ngarkuar me detyrën e mbikëqyrjes së mbrojtjes kibernetike të Kosovës dhe ofrimin e trajnimeve përkatëse përmes Qendrës së Trajnimit për Siguri Kibernetike.³⁸ Megjithëse ligji është miratuar, ekspertët dhe raportet ndërkombëtare tregojnë se Kosova ende nuk e ka një kornizë gjithëpërfshirëse për sigurinë kibernetike, nuk ka mekanizma të mjaftueshëm operacionalë dhe kapacitete teknike por as burime njerëzore për t'i adresuar në mënyrë efektive kërcënimet kibernetike, përfshirë ato që kanë të bëjnë me fushatat e dezinformimit.³⁹

Në nivel strategjik, Kosovës i mungon një plan kombëtar enkas për luftimin e dezinformimit dhe promovimin e edukimit mediatik dhe

digjital. Megjithëse **Agjenda Digjitale për Kosovën 2030** përfshin objektiva për zhvillimin digjital, ajo nuk parashikon masa ose objektiva specifike për kundërpërgjigje ndaj dezinformimit, forcimin e shkathtësive të qytetarëve për konsum kritik të informacionit apo për identifikimin e përmbajtjeve të rreme. Mungesa e një vizioni strategjik dhe e një nisme arsimore të dedikuar lë zbrazëtira të konsiderueshme në ndërtimin e reziliencës shoqërore ndaj manipulimi.

Edhe pse kuadri rregullativ është i mjaftueshëm për t'i garantuar të drejtat themelore, kryesisht përbëhet nga ligje të vjetruara për media tradicionale, ka mungesë rregullimi për mediat online, kapacitet të kufizuar zbatimi në organet vetërregulluese, struktura të dobëta të sigurisë kibernetike, si dhe mungesë përqendrimi strategjik për t'u përballur me këto goditje. Ky fragmentim dhe kuadri i paplotë ligjor krijojnë hapësirë që aktorët e brendshëm dhe të jashtëm t'i shfrytëzojnë këto dobësi.

Aplikimi i kornizës së analizimit të politikave

Duke u mbështetur në hartën e kuadrit rregullativ përkatës të Kosovës, në kapitullin vijues është paraqitur një analizë më e thellë duke aplikuar kornizën e 4R-ve të reziliencës⁴⁰ (qëndrueshmëri, kapacitete rezervë, resurse dhe shpejtësi) për t'i vlerësuar ligjet, rregulloret, politikat dhe strategjitë që kanë të bëjnë me përballjen dhe adresimin e dezinformimit dhe kërcënimeve hibride. Kjo bëhet me qëllim që të kuptohet se si secili përbërës i kuadrit rregullativ kontribuon ose nuk arrin të kontribuojë në kapacitetin e Kosovës për t'u përballur me këto goditje dhe për të reaguar në mënyrë efektive ndaj tyre.

Si pjesë e kësaj analize, janë vlerësuar gjithsej 11 burime. Burimet janë zgjedhur bazuar në aplikimin e tyre në rastet e dezinformimit dhe kërcënimeve hibride dhe përfshijnë politika, ligje, akte nënligjore, udhëzime administrative dhe strategji kombëtare. Ato janë analizuar si në vijim:

Ligji Civil nr. 02/L-65 Kundër Shpifjes dhe Fyerjes




Figura 1: Vlerësim sipas Kornizës së 4R-ve të Ligjit civil nr. 02/L-65 kundër shpifjes dhe fyerjes (Burimi: Analizë individuale)

Ky është ligj i rëndësishëm që ofron mundësi juridike për adresimin e dëmit ndaj reputacionit, e që mund të shërbejë edhe për çështje që kanë të bëjnë me dezinformimin. Megjithatë, ligji demonstron një nivel shumë të ulët të reziliencës ndaj dezinformimit sistemik dhe kërcënimeve hibride, me një vlerësim prej vetëm 17%.

Qëndrueshmëria e këtij ligji është e dobët (notë 1). Edhe pse ligji nuk mbulon çështjet që kanë të bëjnë me kërcënimet hibride, ai ofron një bazë ligjore për trajtimin e dëmit ndaj reputacionit (që mund jetë pasojë e dezinformimit). Megjithatë, ligjit i mungon masa specifike për dezinformim ose ndikim të sponsorizuar nga shtetet. Kapacitetet rezervë janë joekzistuese (notë 0), pasi ligji mbështetet tërësisht në gjykata civile dhe nuk ofron mekanizma alternativë ose sisteme paralele për të sinjalizuar ose zbutur kërcënimet e informacionit përtej procedurave gjyqësore. Edhe resurset janë të kufizuara (notë 1); ligji mundëson përdorimin e burimeve individuale, por i mungojnë komponentët bashkëpunues dhe adaptivë, si fushata të ndërgjegjësimit publik, angazhim me platformat digjitale ose promovim i edukimit mediatik. Shpejtësia është joekzistuese (notë 0), pasi procedurat standarde gjyqësore janë vetvetiu të gjata dhe marrin kohë.

Vlen të theksohet se ligji ka fushëveprim shumë të ngushtë, kryesisht me fokus te dëmi individual i reputacionit. Duke lejuar vetëm procedim civil, ai nuk është i përshtatshëm për të adresuar shpejtësinë, shkallën dhe natyrën sistemike të fushatave të koordinuara të dezinformimit. Politikëbërësit duhet të kuptojnë se, ndonëse ky ligj është i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave individuale, ai nuk ofron mbrojtje domethënëse apo përgjigje efektive ndaj goditjeve si dezinformimi dhe kërcënimet hibride.

Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të dhënave personale




Figura 2: Vlerësim sipas Kornizës së 4R-ve të Ligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale (Burimi: Analizë individuale)

Ky ligj është veçanërisht i rëndësishëm për trajtimin e këtyre goditjeve, pasi ofron mbrojtje të fortë të të dhënave personale, duke mbështetur në mënyrë indirekte reziliencën ndaj tyre përmes mbrojtjes së një vektori kyç sulmi. Ligji mori vlerësim të lartë të reziliencës prej 83 %.

Meqë është në përputhshmëri me GDPR, ka autoritetin e dedikuar mbikëqyrës (Agjencia për Informacion dhe Privatësi) dhe për shkak se ka mekanizma të qartë të zbatimit përmes inspektimeve dhe gjobave, qëndrueshmëria e ligjit është shumë e lartë (notë 3). Kapaciteti i resurseve është gjithashtu i lartë (notë 3), pasi ligji u garanton subjekteve të të dhënave drejta (qasje, korrigjim, fshirje), garanton transparencë dhe mundëson reagim adaptiv. Kapacitetet rezervë janë mesatare (notë 2); parimet e shumë-shtresuara të mbrojtjes së të dhënave dhe ato të minimizimit të të dhënave ofrojnë njëfar mbështetje, por mungojnë plane të posaçshme alternative institucionale nëse komprometohet agjencia kryesore. Shpejtësia është gjithashtu mesatare (notë 2), me afate të përcaktuara për trajtimin e kërkesave të subjekteve të të dhënave, por mungojnë dispozita për sisteme emergjente operative që mundësojnë reagim të shpejtë në raste krizash (p.sh. fushata dezinformimi ose të kërcënimeve hibride që shfrytëzojnë të dhënat personale).

Qëndrueshmëria e lartë e bën më të vështirë për aktorët keqdashës t'i eksploatojnë të dhënat personale për dezinformim, gjë që komplementon përpjekjet për siguri kibernetike në vend (siç shpjegohet më poshtë). Megjithatë përderisa shfaq aftësi të lartë në mobilizimin e resurseve, redundanca kapacitetet rezervë mesatare krijojnë rrezik potencial nëse autoriteti kryesor dështon gjatë një krize. Për sa i përket shpejtësisë, ligji funksionon mirë për mbrojtje standarde, por nuk është adekuat për ndërhyrje të menjëhershme gjatë një krize të informacionit të bazuar në të dhëna. Prandaj, kontributi i tij mbetet kryesisht parandalues.

Ligji nr. 08/L-173 për sigurinë kibernetike




Figura 3: Vlerësim sipas Kornizës së 4R-ve të Ligjit nr. 06/L-173 për sigurinë kibernetike (Burimi: Analizë individuale)

Ky është ligj bazik për mbrojtjen ndaj kërcënimeve kibernetike që prekin hapësirën digjitale të Kosovës. Ligji u vlerësua me reziliencë të përgjithshme prej 75 %, duke e bërë atë mesatarisht rezilient.

Siç është paraqitur në Figurën 3, ligji demonstroi qëndrueshmëri të konsiderueshme (notë 3), duke krijuar një bazë të fortë institucionale me Agjencinë e Sigurisë Kibernetike (ASK), me përgjegjësi të qarta dhe ndëshkime të zbatueshme për shkëlje.⁴¹ Kapacitetet rezervë janë mesatare (notë 2) përmes krijimit të ekipeve të reagimit ndaj incidenteve kibernetike (CSIRT), por mungon thellësia strategjike në infrastrukturën alternative të komunikimit ose planet e plota të emergjencës në rast të dështimit të sistemit kryesor. Po ashtu, kapaciteti i resurseve është mesatar (notë 2), pasi ligji autorizon ASK-në të sigurojë bashkërendim në nivel vendor dhe ndërkombëtar, si dhe të planifikojë trajnime⁴². Megjithatë, vërehen mangësi në përfshirjen e gjerë të aktorëve (shoqëria civile, akterë lokalë) dhe mungesë dispozitash për financim fleksibil apo nxitje të inovacionit në strategjitë e reagimit. Shpejtësia është gjithashtu mesatare (notë 2); ekzistojnë afate të përcaktuara për raportim (njoftim brenda 24 orësh për incidente)⁴³, por kuadrit i mungonjë protokolle të vendimmarrjes së përsheptuar ose mekanizma të koordinimit në kriza, që janë thelbësore për reagime efektive dhe të shpejta ndaj ngjarjeve dinamike kibernetike ose fushatave dezinformuese.

Qëndrueshmëria e lartë e ligjit siguron bazë të fortë për menaxhimin e kërcënimeve kibernetike dhe mund të shërbejë si bazë ligjore për strategjitë përkatëse. Efikasiteti i tij ndaj dezinformimit varet në masë të madhe nga koordinimi me institucionet e tjera, që aktualisht është i dobët. Megjithatë, vlen të theksohet se kapacitetet rezervë mesatare nënkuptojnë se Kosova mbetet e ndjeshme në rast se mbrojtja kryesore kibernetike mbingarkohet gjatë sulmeve të ndërlikuara. Në kuptim të shpejtësisë, ndonëse njoftimet bëhen me kohë, përgjigjet e koordinuara mund të përballen me vonesa procedurale, për shkak të mungesës së protokolleve të posaçme të krizës të përcaktuara gjatë.

Politikëbërësit duhet t'i njohin kufizimet e këtij ligji në trajtimin e goditjeve si dezinformimi dhe kërcënimet hibride. Ligji përgjithësisht mbulon një kusht të domosdoshëm por të pamjaftueshëm për reziliencë; potenciali i tij mund të realizohet plotësisht vetëm përmes drejtimit të fortë strategjik (si Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike), procedurave operative dhe mbi të gjitha, masave plotësuese që adresojnë hapësirën e informacionit.

Udhëzimi Administrativ nr. 04/2024 për Regjistrin e Incidenteve Kibernetike




Figura 4: Vlerësim sipas Kornizës së 4R-ve të Udhëzimit Administrativ nr. 04/2024 për Regjistrin e Incidenteve Kibernetike (Burimi: Analizë individuale)

Ky udhëzim është politikë thelbësore, pasi ndihmon në regjistrimin e incidenteve, por në tërësi tregon mangësi të dukshme në reziliencë. Udhëzimi mori vlerësim prej 58%, që tregon nivel mesatar të reziliencës.

Qëndrueshmëria e udhëzimit është mesatare (notë 2); ai kërkon që ASK të mbajë regjister të sigurt incidentesh dhe përcakton procedura për njoftim, ndjekje dhe analizë.⁴⁴ Megjithatë, nuk parashihen masa specifike për dezinformimin dhe nuk klasifikohen kërcënimet hibride, gjë që kufizon forcën institucionale. Kapacitetet rezervë janë të dobëta (notë 1); edhe pse regjistri përdoret për vlerësimin e rreziqeve të ardhshme⁴⁵, nuk përmenden sisteme rezervë apo regjistra të dytë, duke ofruar pak prova për infrastrukturë funksionale rezervë. Kapaciteti i resurseve është mesatar (notë 2); udhëzimi parashikon raportim anonim të incidenteve përmes faqes së ASK-së⁴⁶, që mund ta zgjerojë inputin, por mungon përfshirja e aktorëve tjerë. Shpejtësia është gjithashtu mesatare (notë 2); ASK ka detyrim të reagojë shpejt ndaj incidenteve të raportuara⁴⁷, por udhëzimi nuk përfshin protokolle të bashkëpunimit ndërinstitucional apo procese të përsheptuara për veprime urgjente.

Siç qëndron tani, udhëzimi ofron procedura solide administrative dhe operative për regjistrimin e incidenteve, por mungesa e klasifikimeve specifike për incidentet hibride ose të lidhura me dezinformimin kufizon dobishmërinë e tij për analiza të targetuara. Redundanca e dobët e bën sistemin përgjithësisht të ndjeshëm, ndërsa detyrimi i ASK-së për reagim të shpejtë është pozitiv. Por, në mungesë të protokolleve për bashkëpunim ndërinstitucional, ka rrezik të veprimeve të ngadalta të koordinuara. Politikëbërësit duhet të konsiderojnë përmirësimet, veçanërisht në drejtim të qëndrueshmërisë, kapaciteteve rezervë dhe shpejtësisë.

Udhëzimi Administrativ nr. 04/2024 për Regjistrin e Rreziqeve dhe Kërcënimeve të Sigurisë Kibernetike




Figura 5: Vlerësim sipas Kornizës së 4R-ve të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2024 për Regjistrin e rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë kibernetike (Burimi: Analizë individuale)

Ky udhëzim u vlerësua me reziliencë të lartë, me vlerësim 83%. Kjo bën që udhëzimi të ofroj një kuadër të fortë për identifikimin dhe menaxhimin sistematik të rreziqeve kibernetike.

Qëndrueshmëria është e lartë (notë 3), pasi udhëzimi krijon regjistër të detyrueshëm dhe të organizuar për rreziqet kibernetike, të menaxhuar nga ASK në bashkëpunim me institucione të tjera, të mbështetur me kriterë klasifikimi dhe mjete analitike.⁴⁸ Kapaciteti i resurseve është gjithashtu i lartë (notë 3), pasi udhëzimi nxit zhvillimin e mjeteve dhe udhëzimeve të specializuara, integron disa organizata (ushtrinë, operatorët e telekomunikacionit, rregullatorët) dhe ofron vlerësime fleksibile të rrezikut⁴⁹, duke nxitur sjellje bashkëpunuese dhe adaptive institucionale. Kapacitetet rezervë janë mesatare (notë 2); ndonëse sistemi prioriteton dhe regjistron rreziqet, nuk krijon nivele operative rezervë ose regjistra alternativë për të parandaluar dështimin në rast komprometimi të regjistrit kryesor. Shpejtësia është gjithashtu mesatare (notë 2), pasi udhëzimi nuk parashikon veprime urgjente ose eskalim të menjëhershëm të kërcënimeve në kohë reale bazuar vetëm në të dhënat e regjistrit. Megjithatë, ai përfshin raportim vjetor dhe përditësim të vazhdueshëm të të dhënave.

Përparësitë e udhëzuesit janë sistemi i qëndrueshëm për identifikimin e rreziqeve dhe bashkëpunimi i lartë ndërinstitucional, duke mbështetur drejtpërdrejt Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike përmes ofrimit të të dhënave sistematike. Efikasiteti i tij në një krizë varet kryesisht nga integrimi me politika të tjera që mund ta përkthejnë rrezikun e identifikuar në veprime konkrete.

Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2023–2027⁵⁰




Figura 6: Vlerësim sipas Kornizës së 4R-ve të i Strategjisë Kombëtare për Siguri Kibernetike 2023–2027 (Burimi: Analizë individuale)

Kjo strategji është një tjetër politikë rregullative e rëndësishme, e cila operacionalizon Ligjin për Sigurinë Kibernetike (diskutuar më lart), duke synuar reziliencë kibernetike të koordinuar. Strategjia është vlerësuar si shumë reziliente, me vlerësim 83 %.

Siç paraqitet në Figurën 6, strategjia demonstroi qëndrueshmëri të lartë (notë 3); ajo përcaktoi qartë përgjegjësi të institucionale për subjektet si Ministria e Punëve të Brendshme dhe ASK, mandatoi krijimin e ekipeve sektoriale për reagim ndaj incidenteve kibernetike (CSIRT) dhe kërkoi auditime periodike të sigurisë për operatorët e infrastrukturës kritike (faqe 20–22, 34–38). Kapaciteti i resurseve është gjithashtu i lartë (notë 3), pasi strategjia promovon qasje multisektoriale, përfshirë bashkëpunimin ndërmjet qeverisë, sektorit privat dhe akademisë, përcaktoi një sistem kombëtar të menaxhimit të rrezikut kibernetik dhe planifikoi përfshirjen e OSHC-ve në fushatat e vetëdijesimit (faqe 25, 22, 28, 40–41), duke treguar sistem reagimi fleksibil dhe të koordinuar mirë. Megjithatë, kapacitetet rezervë janë mesatare (notë 2); edhe pse strategjia nxitë identifikimin e cenueshmërive dhe aplikimin e CSIRT-ve (faqe 22–24), ajo nuk siguron kapacitete rezervë funksionale midis sektorëve, apo plane të hollësishme rezervë për veprime në rast emergjence. Shpejtësia është gjithashtu mesatare (notë 2); strategjia parashikon procedurë emergjente reagimi si Ekipi Kombëtar për Reagim Emergjent (EKRSH) dhe njoftimet e hershme paralajmëruese (faqet 26, 40), por nuk përcaktohen procedurë emergjente të detyrueshme ligjrisht apo mekanizma të përshtetshëm të ndarjes së resurseve.




Figura 7: Vlerësim sipas Kornizës së 4R-ve të i Strategjisë Kombëtare të Sigurisë 2022–2027
(Burimi: Analizë individuale)

Kjo është strategji gjithëpërfshirëse, e cila njih një sërë kërcënimesh. Megjithatë, ajo shpërfaqë reziliencë të ulët ndaj sfidave specifike të dezinformimit dhe kërcënimeve hibride, me vlerësim prej 50%.

Qëndrueshmëria është mesatare (notë 2), pasi strategjia njih kërcënimet hibride, përfshirë fushatat e dezinformimit dhe sulmet kibernetike, dhe përcakton përgjegjësi për institucione si Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI) dhe Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK) (faqet 7–8). Megjithatë, mjetet dhe mekanizmat operativë për reagim ndaj dezinformimit janë të përgjithshme dhe të pazhvilluara. Kapacitetet rezervë janë të dobëta (notë 1); strategjia thekson mungesën e infrastrukturës adekuatë dhe varësinë nga marrëveshjet bilaterale për inteligjencë (faqe 9), por nuk parashihen sistemet paralele apo komunikimi alternativ për të parandaluar dështimin gjatë sulmeve hibride. Kapaciteti i resurseve është mesatar (notë 2), pasi strategjia pasqyron adaptueshmëri institucionale dhe synon forcimin e qeverisjes, por i mungon bashkëpunimi ndërsektorial (veçanërisht me mediat dhe OSHC-të për çështjet e dezinformimit). Shpejtësia është e dobët (notë 1), pasi strategjia nuk përmban mekanizma konkrete të reagimit të shpejtë, të përshtatur enkas me urgjencën e fushatave dezinformuese apo kërcënimeve hibride.

Megjithëse kjo strategji përbën një instrument të rëndësishëm kombëtar të sigurisë, niveli i ulët i reziliencës tregon se ajo nuk është e pajisur mirë për t'u përballur në mënyrë efektive me dezinformimin dhe kërcënimet hibride. Është e rëndësishme që strategjia të rishikohet për të përfshirë mjete të forta kundër dezinformimit, ta forcojë redundancën përmes planeve të emergjencës dhe të vendosë mekanizma të qartë reagimi të shpejtë në krizë, që integrohen në mënyrë efektive me strategjitë e tjera kombëtare.

Ligji nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM)




Figura 8: Vlerësimi sipas kornizës së 4R-ve i ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media (Burimi: Analizë individuale)

Ky ligj është i rëndësishëm pasi me të themelohet KPM si rregullator i mediave audiovizuale në Kosovë. Megjithëse ka rol të rëndësishëm në luftimin e dezinformimit dhe kërcënimeve hibride në media, ligji mori vlerësim prej 50%, që tregon reziliencë të ulët.

Qëndrueshmëria është e lartë (notë 3) për fushën e mandatit të tij. Ligji themelon KPM-në si organ të pavarur me mandat kushtetues, të ngarkuar me licencimin, monitorimin dhe sanksionimin e transmetuesve audiovizuel, me vendime ligjërish të detyrueshme dhe të përmbarueshme.⁵² Përmes kësaj, ligji krijon strukturë të fortë qeverisjeje institucionale për mediat tradicionale të transmetimit. Megjithatë, kapacitetet rezervë janë të dobëta (notë 1), pasi ligji nuk parashikon struktura mbikëqyrëse alternative ose mekanizma rezervë në rast se KPM mbingarkohet ose komprometohet. Edhe pse ligji parashikon bashkëpunim me institucione të tjera⁵³, nuk janë përcaktuar procedurat alternative ose rrugët e shumëfishta të zbatimit. Kapaciteti i resurseve është gjithashtu i dobët (notë 1); megjithëse KPM mund të krijojë rregulla të brendshme dhe të bashkërendohet me Kuvendin e Kosovës, ligji nuk nxit bashkëpunim më të gjerë me aktorë të tjerë, si OSHC-të apo platformat teknologjike për luftimin e dezinformimit, si dhe nuk ka mjete adaptive siç janë sistemet digjitale të monitorimit. Shpejtësia është gjithashtu e dobët (notë 1); ndonëse KPM ka autoritet për pezullim licencash dhe shqiptim të ndëshkimeve, ligji nuk parasheh procedura emergjente apo mekanizma të përshpejtuar për trajtimin e goditjeve si dezinformimi ose kërcënimet hibride në media.

Në formën e tanishme, megjithëse ky ligj përbën hap pozitiv drejt ndërtimit të reziliencës kundër dezinformimit, ai mbetet kryesisht joefikas ndaj kanaleve moderne të dezinformimit dhe kërcënimeve hibride. Fushëveprimi i tij i kufizuar (duke përjashtuar mediat online), së bashku me dobësitë e tjera të përmendura, nënkupton se ligji nuk mund të shërbejë si shtyllë qendrore e përpjekjeve të Kosovës për të luftuar dezinformimin.

Kodi i Mediave të Shkruara (KPM-2016/03)⁵⁴




Figura 9: Vlerësimi Kodit sipas Kornizës së 4R-ve (Burimi: Analizë individuale)

Megjithëse i rëndësishëm në përcaktimin e standardeve profesionale, Kodi i Etikës i KPM-së demonstroi reziliencë mesatare ndaj dezinformimit dhe kërcënimeve hibride, me vlerësim prej 58%.

Siç është paraqitur në Figurën 9, kodi ka qëndrueshmëri të lartë (notë 3), pasi përcakton kërkesat ligjërisht të detyrueshme si saktësia, paanshmëria dhe korrigjimi i përbajtjeve të pasakta. Kodi mbështetet nga Ligji për KPM-në dhe, përmes tij, mund të zbatohet ndëshkime, si gjoha ose pezullime të licencave, duke siguruar llogaridhënie dhe promovuar stabilitet sistemik. Kapacitetet rezervë janë të dobëta (notë 1); megjithëse ndëshkimet janë ligjërisht të detyrueshme dhe nuk kërkojnë ndërhyrje të tjera gjyqësore, sistemi nuk ka mekanizma rezervë në rast se KPM nuk është në gjendje të veprojë ose komprometohet. Për më tepër, emërimi i bordit të KPM-së nga Kuvendi i Kosovës paraqet rrezik potencial për ndikim politik, duke kufizuar reziliencën për shkak të varësisë nga një aktor i vetëm pa mbikëqyrje të mbrojtur. Kapaciteti i resurseve është mesatar (notë 2), pasi kodi përfshin mekanizma llogaridhënieje si e drejta për përgjigje dhe korrigjim. Megjithatë, mungojnë kuadrot bashkëpunuese që do t'i ndihmonin mediat që të përshtaten ndaj kërcënimeve hibride apo taktikave të reja të dezinformimit përtej etikës tradicionale të transmetimit. Shpejtësia është gjithashtu e dobët (notë 1); megjithëse ka afat shtatëditor për të drejtën e përgjigjes, kodi nuk përfshin masa emergjente, rishikime të përsheptuara apo mekanizma të zbatimit të shpejtë për situata urgjente.

Efikasiteti i Kodit është i lidhur ngushtë me Ligjin për KPM-në, i cili kufizon zbatueshmërinë e tij vetëm për mediat audiovizuale të licencuara, duke përjashtuar sferën online, ku ndodh pjesa më e madhe e dezinformimit. Kodi ka nevojë për një modernizim të thellë, ashtu që ta zgjerojë mandatin e tij për të mbuluar sferën online, shoqëruar me masa të reja për forcimin e pavarësisë, krijimin e mekanizmave rezervë dhe mekanizmave bashkëpunues të reagimit.

Kodi i Mediave të Shkruara i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës




Figure 10: Vlerësim sipas Kornizës së 4R-ve i Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës (Burimi: Analizë individuale)

Kodi i Mediave të Shkruara është kuadër etik vetërregullues për gazetarët, redaktorët dhe botuesit, dhe është i rëndësishëm sepse është e vetmja politikë rregullative që mund të zbatohet për platformat dhe mediat online. Kodi mori vlerësim prej 42%, që tregon reziliencë të ulët ndaj dezinformimit dhe kërcënimeve hibride.

Fig. 10 tregon kufizimet e tij. Kodi demonstroi qëndrueshmëri të dobët (notë 1); megjithëse promovon etikën profesionale si raportimin e vërtetë dhe mosdiskriminimin, zbatimin e këtyre rregullave mbështetet në përmbushje vullnetare dhe kontroll kolegial, e jo në autoritet ligjor. Kapacitetet rezervë janë gjithashtu të dobëta (notë 1); edhe pse kriteret për paanshmëri, raportim të balancuar dhe të drejtën e përgjigjes ndikojnë në rritjen e kapaciteteve rezervë për raportim etik dhe larmishmëri të informacionit, kodi nuk përcakton mbrojtje sistematike ndaj dezinformimit, siç janë rrejet bashkëpunuese të verifikimit të fakteve apo protokollet për ruajtjen e integritetit të informacionit në disa platforma gjatë krizave. Kapaciteti i resurseve është gjithashtu i dobët (notë 1), pasi mungojnë dispozitat për përshtatjen më të gjerë institucionale apo përdorimin e inovacionit teknologjik, të cilat janë thelbësore për reziliencën adaptive. Shpejtësia është mesatare (notë 2), pasi kodi thekson korigjimin e shpejtë të informacionit të rremë, por nuk parashikon procedura emergjente apo sisteme në kohë reale për t'i kundërshtuar sulmet e koordinuara apo fushatat dezinformuese vizuale.

Kufizimi kryesor i Kodit të Mediave të Shkruara qëndron në natyrën e tij vetërregulluese, e cila është e pamjaftueshme kundrejt aktorëve të jashtëm të kërcënimeve hibride, shpesh të mbështetur nga shtete që nuk i përmbahen këtyre standardeve etike. Kontributi i tij kryesor qëndron në nxitjen e sjelljes etike brenda komunitetit profesional gazetaresk, që është komponent thelbësor i ekosistemit të shëndetshëm informativ. Megjithatë, kodi mund të shërbejë si bazë etike mbi të cilën mund të ndërtohen masa më të forta rregullative ose bashkërregulluese, duke siguruar që përpjekjet kundër dezinformimit të mos cenojnë liritë gazetareske.




Figura 11: Vlerësim sipas Kornizës së 4R-ve të Agjendës Digjitale për Kosovën 2030
(Burimi: Analizë individuale)

Edhe pse nuk është strategji e dedikuar për luftimin e dezinformimit, Agjenda Digjitale përfshin elemente të rëndësishme për ndërtimin e reziliencës ndaj dezinformimit dhe kërcënimeve hibride, me vlerësim prej 58%.

Strategjia demonstroi qëndrueshmëri mesatare (notë 2); ajo njihë ekzistencën e dezinformimit dhe kërcënimeve hibride në kontekstin e reziliencës kibernetike dhe përcakton përgjegjësi institucionale (ASK, Ministria e Punëve të Brendshme), duke synuar harmonizim me standardet e BE-së dhe NATO-s. Megjithatë, nuk ceket asnjë kuadër ligjor i zbatueshëm që trajton drejtpërdrejt dezinformimin ose kërcënimet hibride. Kapacitetet rezervë janë të dobëta (notë 1); edhe pse strategjia nxitë mediane pavarur dhe ndërgjegjësimin publik, mungojnë masa institucionale ose sistematike rezervë. Kapaciteti i resurseve është i lartë (notë 3), meqë strategjia promovon bashkëpunimin ndërmjet qeverisë, partnerëve të huaj, mediave dhe OSHC-ve, si dhe nxit reagues adaptive përmes fushatave edukuese dhe nismave për ngritje kapacitetesh. Shpejtësia është e dobët (notë 1); edhe pse ceken sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe monitorimit të kërcënimeve, mungojnë metoda të zyrtarizuara të reagimit të shpejtë apo procedura të përsheptuara institucionale.

Agjenda Digjitale mund të kontribuojë pozitivisht në ndërtimin afatgjatë të reziliencës, duke forcuar aftësitë digjitale dhe edukimin mediatik. Megjithatë, nevojiten masa më konkrete në këtë drejtim, veçanërisht për përfshirjen e edukimit mbi dezinformimin dhe edukimin mediatik në shkolla të mesme dhe në arsimin e lartë.

Diskutim i gjetjeve

Vlerësimi përmes kornizës së 4R-ve i kuadrit rregullativ të Kosovës nxjerr në pah një sistem të fragmentuar dhe të pazhvilluar për të luftuar nivelin e dezinformimit dhe kërcënimeve hibride me të cilat vendi është përballur dhe vazhdon të përballlet. Me një reziliencë të përgjithshme prej 59% (reziliencë mesatare), kuadri rregullativ tregon disa anë të forta (veçanërisht në fushën e sigurisë kibernetike); megjithatë, rezilienca sistematike minohet ndjeshëm nga hendeqet kritike në të katër dimensionet e kornizës së 4R-ve.

Tabela 5: Rezultati total i politikave të vlerësuara

#	Politikat	Vlerësimi	Pikët maksimale
1	Ligji civil nr. 02/L-65 kundër shpifjes dhe fyerjes	2	
2	Ligji nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale	10	
3	Ligji nr. 08/L-173 për sigurinë kibernetike	9	
4	Udhëzimi Administrativ nr. 04/2024 për Regjistrin e incidenteve kibernetike	7	
5	Udhëzimi Administrativ nr. 04/2024 për Regjistrin e rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë kibernetike	10	
6	Strategjia Kombëtare për Siguri Kibernetike 2023 - 2027	10	132
7	Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2022–2027	6	
8	Ligji nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM)	6	
9	Kodi i Mediave të Shkruara (KPM-2016/03)	7	
10	Kodi i Mediave të Shkruara i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës	5	
11	Agjenda Digjitale për Kosovën 2030	7	
Gjithsej		79	59%

Çështjet e qëndrueshmërisë paraqesin shqetësime serioze në përpjekjet për të adresuar ose luftuar dezinformimin dhe kërcënimet hibride. Ligji i vjetërsuar për KPM-në, i cili nuk arrin të mbulojë mediat online, lë një hendek të madh rregullativ. Për më tepër, politikat e hartuara për mediat tradicionale ose udhëzimet etike, si Kodi Etik i KPM-së dhe Kodi i Mediave të Shkruara, tregojnë reziliencë shumë të ulët apo të ulët ndaj fushatave të koordinuara të dezinformimit, pasi u mungon autoriteti ligjor, fushëveprimi i duhur dhe mekanizmat e zbatimit. Edhe politikat të cilat në vete kanë qëndrueshmëri, si Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kanë zbatim të kufizuar në përballjen me dezinformimin.

Për më tepër, vlerësimi zbuloi një mungesë të vazhduar e të theksuar të kapaciteteve rezervë sistematike në kuadrin rregullativ. Në përgjithësi, vërehet një varësi e tepërt në institucione të vetme në kuadër të fushës së tyre

përkatëse (p.sh. KPM për mediat audiovizuale, ASK për sigurinë kibernetike, KMSHK për etikën e mediave online) pa sisteme rezervë të përcaktuara qartë, protokolle alternative operacionale, apo plane emergjente për adresimin e dështimeve institucionale ose mbingarkesën gjatë krizave. Dokumentet e tjera strategjike gjithëpërfshirëse, si Strategjia e Sigurisë së Kosovës, pranojnë ekzistencën e hendeqeve në koordinim, por nuk përcaktojnë konkretisht mekanizma rezervë. Kjo mungesë e redundancës në kuadrin rregullativ rrit ndjeshmërinë e tij ndaj ndërprerjeve që shkaktohen nga dezinformimi dhe kërcënimet hibride.

Adaptueshmëria dhe qasjet bashkëpunuese shumëpalëshe janë gjithashtu të nënzhvilluara, gjë që sjell burimësi të kufizuar sistematike. Megjithatë instrumentet si Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike dhe Agjenda Digjitale promovojnë qasje shumëpalëshe, kjo nuk reflektohet në pjesën tjetër të kuadrin rregullativ. Shumica e ligjeve i japin prioritet strukturave administrative para atyre për nxitje të inovacionit ose bashkëpunimit të gjerë institucional. Një tjetër mangësi e rëndësishme është mungesa e një strategjie gjithëpërfshirëse kombëtare apo një platforme të institucionalizuar e të dedikuar për nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm në funksion të luftimit të dezinformimit dhe kërcënimeve hibride, përfshirë qeverinë, agjencitë e sigurisë, politikëbërësit, OSHC-të, akademinë dhe platformat teknologjike. Gjithashtu, mungesa e një strategjie kombëtare për rritjen e edukimit mediatic (veçanërisht brenda sistemit arsimor formal) paraqet një mangësi madhore në ndërtimin e reziliencës shoqërore për t'i rezistuar manipulimit dhe fushatave dezinformuese.

Vlerësimi gjithashtu thekson mungesën e shpejtësisë në të gjithë spektrin e politikave. Shpejtësia e përhapjes së dezinformimit (veçanërisht përmes platformave online) tejkalon ndjeshëm kapacitetin e reagimit që ofron kuadri aktual rregullativ. Shumica e politikave të vlerësuara nuk përmbajnë dispozita specifike për zbulim të shpejtë, aftësi analitike në kohë reale, procese të përsheptuara të vendimmarrjes apo protokolle për koordinim emergjent. Edhe politikat që tregojnë shpejtësi mesatare në disa aspekte (p.sh. Ligji për Sigurinë Kibernetike) nuk kanë plane konkrete të veprimit në kriza për reagim të shpejtë dhe të koordinuar. Politikat që bazohen në vetërregullim (p.sh. KMSHK) ose në procedura gjyqësore (p.sh. Ligji për Shpifjen) janë shumë të ngadalta për të qenë efektive ndaj dezinformimit. Kjo mungesë sistematike e shpejtësisë bën që ndërhyrjet të jenë të vonuara dhe të pamjaftueshme për të zbutur apo adresuar ndikimin e dezinformimit dhe kërcënimeve hibride.

Një tjetër gjetje e rëndësishme është shkalla e lartë e fragmentimit dhe mungesa e kohezionit strategjik midis politikave të ndryshme të analizuara. Për shembull, përpjekjet në fushën e sigurisë kibernetike, ndonëse më të avancuara, kanë lidhje të dobët me kuadrin rregullativ të hapësirës së informacionit. Në të njëjtën mënyrë, Strategjia e Sigurisë së Kosovës nuk ka arritur të integrojë në mënyrë efektive masa specifike për kundërshtimin e dezinformimit si rrezik sigurie, duke krijuar shkëputje strategjike. Ngjashëm, Agjenda Digjitale, ndonëse përmend objektiva për edukimin digjital, ka mungesë të lidhjeve operacionale me kuadrat e sigurisë apo zbatimin rregullativ të lidhur me dezinformimin.

“Shpejtësia e përhapjes së dezinformimit (veçanërisht përmes platformave online) tejkalon ndjeshëm kapacitetin e reagimit që ofron kuadri aktual rregullativ”

Konkluzione dhe rekomandime

Adresimi i dezinformimit dhe kërcënimeve hibride paraqet një sfidë komplekse, që kërkon balancim të kujdesshëm për të shmangur cenimin e të drejtave themelore, si liria e shprehjes dhe liria e mediave. Megjithatë, analiza e mësipërme dhe studimet e realizuara në këtë fushë tregojnë qartazi për një cenueshmëri të konsiderueshme brenda kuadrit aktual rregullativ, duke e bërë të domosdoshme ndërhyrjen strategjike dhe gjithëpërfshirëse përtej përpjekjeve ekzistuese të fragmentuara. Rekomandimet në vijim synojnë të forcojnë kuadrin rregullativ, duke mësuar nga praktikatat më të mira, veçanërisht ato të Bashkimit Evropian (BE) në lidhje me Shërbimet Digjitale (DSA) dhe dezinformimin, duke i përshtatur me kontekstin specifik të Kosovës.

Vlerësimi nxori vazhdimisht në pah dobësi kritike në të katër dimensionet e kornizës së 4R-ve të reziliencës. Për të ndërtuar një kuadër më rezilient, prioriteti kryesor duhet të jetë modernizimi i kuadrit rregullativ për hapësirën e informacionit në Kosovë, veçanërisht për sa i përket mediave online. Kjo kërkon reformë gjithëpërfshirëse përmes ndryshimeve thelbësore në Ligjin për KPM-në, për t'i përcaktuar mandat të qartë dhe të zgjeruar që mbulon mediat online (portalet e lajmeve dhe platformat digjitale), me burime adekuate dhe pavarësi institucionale. Kjo reformë është jetike për forcimin institucional në një fushë ku aktualisht ka mungesë të theksuar.

“Ndërtimi i reziliencës shoqërore është ndoshta aspekti më sfidues, pasi kërkon investime të dedikuara afatgjate.”

Paralelisht me reformën e Ligjit për KPM-në, është thelbësore që të miratohen masa legislative specifike që rrisin transparencën dhe llogaridhënien në hapësirën online, duke nxjerrë mësim nga Akti i Shërbimeve Digjitale të BE-së (DSA) dhe Kodi i Forcuar i Praktikës për Dezinformimin. Në vend që të hartohen ligje ose rregullore që mund të rrezikojnë censurimin e përmbajtjes, duke ngritur kështu shqetësime të mëdha mbi lirinë e shprehjes, legjislacioni duhet të fokusohet në dinamikën e përhapjes së dezinformimit. Kjo mund të përfshijë (i) transparencë të detyrueshme për reklamën politike online, duke kërkuar nga platformat që operojnë në Kosovë të mbajnë arkiva publike të qasshme për reklamën, ngjashëm me kërkesat në kuadër të DSA-së, (ii) etiketim të qartë të përmbajtjes së sponsorizuar nga shtetet, (iii) krijimin e mekanizmave për trajtimin e sjelljeve të koordinuara joautentike (si rrjetet e botëve digjitale).

Për më tepër, zbatimi i një qasjeje të bazuar në rrezik dhe të përshtatur sipas

përmasave për platformat online mund të jetë i dobishëm. Në këtë mënyrë, platformat online do të kenë detyrim të vlerësojnë dhe të zbusin rreziqet sistemike të dezinformimit (ngjajshëm me nenin 34 të Aktit për Shërbime Dixhitale - DSA), nën mbikqyrjen e KPM-së. Gjithashtu, eksplorimi i një modeli bashkë-rregullues që ndërthur rregullimin formal dhe vetërregullimin e strukturuar, i frymëzuar nga Kodi i Forcuar i Praktikës i BE-së, mund të nxisë përgjegjësinë e industrisë. Përpyekjet kyçe që mund të zbatohen përfshijnë demonetizimin e përmbajtjeve dezinformuese, rritjen e integritetit të shërbimeve kundër llogarive të rreme dhe botëve (bots) të ndërtuar me inteligjencë artificiale, fuqizimin e përdoruesve, si dhe lehtësimin e qasjes së sigurt të hulumtuesve në të dhëna për analizimin e dezinformimit, duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave (GDPR).

Përtej rregullimeve specifike që kanë të bëjnë me mediat dhe platformat online, është thelbësore të forcohet kohezioni strategjik dhe kapaciteti institucional në të gjitha institucionet publike. Strategjia e Sigurisë së Kosovës duhet të rishikohet ashtu që të integrohen masa për të luftuar dezinformimin dhe kërcënimet hibride si prioritete thelbësore. Po ashtu, kjo strategji, si instrument gjithëpërfshirës, duhet t'i përcaktojë qartë rolet ndërinstitucionale dhe të sigurojë lidhje efektive me strategjitë e tjera (p.sh. Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike). Njëkohësisht, kapaciteti operacional i institucioneve përkatëse duhet të forcohet përmes financimit adekuat, trajnimeve të specializuara dhe burimeve teknike, duke ruajtur pavarësinë e tyre institucionale.

Ndërtimi i reziliencës shoqërore është ndoshta aspekti më sfidues, pasi kërkon investime të dedikuara afatgjate. Në këtë drejtim, është me rëndësi të lartë miratimi dhe zbatimi i qëndrueshëm i Strategjisë Kombëtare për Edukimin Mediatic dhe Informativ. Është i domosdoshëm integrimi i kësaj strategjie dhe veprimeve përkatëse në sistemin arsimor formal dhe programet publike mbështetëse (arsimi joformal) për t'i fuqizuar qytetarët me shkathtësi të edukimit mediatic dhe luftimit të dezinformimit. Po ashtu, nxitja e një mjedisi mediatic të pavarur pluralist dhe të qëndrueshëm, përmes mekanizmave transparentë të financimit publik dhe mbështetjes së gazetarisë cilësore, do t'u siguronte qytetarëve burime të larmishme dhe të besueshme informacioni, që veprojnë si mburojë natyrale ndaj dezinformimit dhe kërcënimeve hibride.

Gjatë gjithë këtij procesi, është me rëndësi forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përafrimi me standardet ndërkombëtare. Angazhimi i vazhdueshëm me BE-në, NATO-n dhe partnerët bilateralë për shkëmbim të inteligjencës, aplikimi i praktikave të mira dhe harmonizimi i kuadrit të Kosovës me standardet ndërkombëtare në zhvillim, veçanërisht me zbatimin e DSA-së dhe nismave relevante, do të jetë kyç për ndërtimin e një rezilience moderne, efektive dhe me respektim të plotë të të drejtave të njeriut ndaj dezinformimit dhe kërcënimeve hibride.

Siç u theksua gjatë tërë dokumentit, adresimi i këtyre sfidave kërkon ndërhyrje strategjike dhe gjithëpërfshirëse, përtej përpjekjeve fragmentare aktuale. Në vijim, përkushtimi i qëndrueshëm për zbatimin e reformave është kyç për forcimin e kapaciteteve të institucioneve për përballje dhe luftimin të dezinformimit dhe kërcënimeve hibride.

Biblografia

1. Klasifikuar bazuar në dokumentin e OECD-së (2014) “Udhëzimet për analizën e sistemeve të reziliencës: Si të analizohen rreziqet dhe të ndërtohet një udhërrëfyes për reziliencë”. Botim i OECD.

2 Vishnska, I. (2023) “Perspektiva gjeopolitike e rrjedhave të dezinformimit në Ballkanin Perëndimor”. Fondacioni Metamorfozis për Internetin dhe Shoqërinë.

3 NDI (2022) “Integriteti i Informacionit në Kosovë: Vlerësimi i ekonomisë politike të dezinformimit”. Instituti Demokratik Kombëtar.

4 Zamfir, R. (2020) “Rreziqet dhe dobësitë në Ballkanin Perëndimor”. Qendra e Ekselencës për Komunikimet Strategjike të NATO-s.

5 Burmester, I, etj., (2025) “Vlerësimi i kërcënimit politik në shtetet e fqinjësisë lindore dhe të Ballkanit perëndimor”. ReUnir Working Paper.

6 Po aty, 2.

7 Po aty, 3

8 Po aty 2.

9 EUvsDinfo (2019) “700 lajme të reja të rreme në tabloidët serbë në vitin 2018”. EUvsDisinfo.

10 Disinfo (2022) “Keqinformimi i opinionit publik në Serbi si strategji zgjedhore”. Sbunker

11 Zamfir, R. (2019) “Propagandë sipas masës: Dimensionet e rrezikut dhe rezistencës në Ballkanin Perëndimor”. Global Focus/The Balkan Trust for Democracy.

12 Zyra e Kryeministrit (2024). Nënshkruhet marrëveshja me prodhuesin shtetëror turk të industrisë së mbrojtjes “Makine ve Kimya Endüstrisi”. Qasur së fundi më: 5 maj 2025.

13 Die Morina (2018) “Ministri dhe shefi i inteligjencës së Kosovës shkarkohen për shkak të arrestimeve në Turqi”. BIRN/Balkan Insights (Qasja e fundit: 5 maj 2025).

14 Shaban Mexharraj (2025) “Gjashtëshja kundër Turqisë’ nuk heq dorë nga Prizreni, Zyrtarët heshtin”. Koha.

15 Po aty.

16 Po aty, 11.

17 Nisma “Brezi dhe Rruga” (e njohur edhe si “Një Brez, një Rrugë”) është një strategji ndërkombëtare e zhvillimit të infrastrukturës e zbatuar dhe e financuar nga Qeveria Kineze. Shihni më shumë në: Portali “Një Brez, një Rrugë”.

18 Gashi, K. (2024) “Papërgatitja Institucionale: Sfida e Kosovës kundër dezinformimit”. Balažič, P. & Brglez, L (2024) “Mirazhi i së Vërtetës:” Kompleksitetet dhe sfidat e dezinformimit në Ballkanin Perëndimor”. Qendra për Perspektivë Evropiane.

19 Disfo (2022) “Nën mbikëqyrjen e kamerave të dyshimta kineze”. Sbunker

20 Mehmeti, J (2021) “Korniza kombëtare rregullatore dhe vetërregulluese kundër gjuhës së urrejtjes dhe dezinformimit”. SEENPM, Peace Institute dhe Kosovo 2.0.

21 Po aty, 3.

22 ISD (2024) “Monitorimi i fushatave të ndikimit dhe dezinformimit në Ballkanin Perëndimor”.

23 Kushtetuta e Republikës së Kosovës

24 Ligji Nr. 02/L-65 ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes. Nenet 14 dhe 15.

25 Ligji nr. 04/L-137 për mbrojtjen burimeve të gazetarëve.

26 Ligji nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve.

27 Ligji nr. 03/L-081 për qasjen dokumente publike.

28 Ligji nr. 06/L082 për mbrojtjen e të dhënave personale.

29 Po aty, 3.

30 Ligji nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave. Neni 3(2).

31 Po aty, 3.

32 Po aty, 2.

33 Po aty, 30. neni 11.

34 Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës, mars 2005

35 Po aty, 3.

36 Po aty.

37 Ligji nr. 08/L-173 sigurisë kibernetike.

38 Po aty, nenet 12 dhe 21.

39 Po aty, 14.

40 Për më shumë informacion në lidhje me metodologjinë, ju lutemi shihni kapitullin e metodologjisë.

41 Po aty, 37. Nenet 12-16 dhe 24.

42 Po aty. Neni 9.

43 Po aty. Neni 6.

44 Udhëzimi Administrativ nr. 04/2024 për Regjistrin e incidenteve kibernetike. Neni 4 (5).

45 Po aty. Neni 4(2)

46 Po aty. Neni 5(2)

47 Po aty. Neni 5(1) dhe (3)

48 Udhëzimi Administrativ nr. 05. 04/2024 për Regjistrin e rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë kibernetike. Nenet 1-7.

49 Po aty. Neni 2 dhe 8.

50 Qeveria e Republikës së Kosovës (2023). Strategjia Kombëtare për Siguri Kibernetike 2023 - 2027

51 Qeveria e Republikës së Kosovës (2022). Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022 - 2027.

52 Po aty, 30. Nenet 1 -4.

53 Po aty. Art. 8

54 Komisioni i Pavarur për Media. Kodi i Etikës për KPM-në.

55 Qeveria e Republikës së Kosovës (2023). Agjenda Digjitale për Kosovën 2030..

